



# TAKIM KOMBËTAR I GRUPEVE LOKALE TË VEPRIMIT DHE GLV-VE POTENCIALE

## Qasja LEADER në Shqipëri:

*Si mund ta kthejmë mbështetjen e IPARD III në çelësin për zbatimin e suksesshëm mbarëkombëtar të qasjes Leader?*

*Hotel Mondial, 23 shtator 2021, 10:30 - 13:00*

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin Menaxhues të IPARD në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural organizon eventin kombëtar mbi qasjen Leader me synim për t'i dhënë një hov të ri zbatimit të kësaj qasje pas periudhës së gjatë të pritjes për të pasur një sipërmarrje të mundshme kombëtare që mbështet jetësimin e qasjes Leader në komunitetet rurale të vendit tonë.

Ky event mbështet dhe promovon nismat e tipit Leader të ndërmarra nga aktorët zhvillimorë në Shqipëri që në fillim të viteve 2000 deri më sot, të cilat janë hartëzuar me përpjekje të përbashkëta të organizatorëve të këtij eventi dhe të identifikuar në Dokumentin e Politikave [‘Dinamikat e zbatimit të qasjes Leader në Shqipëri dhe e ardhmja’](#). Këto nisma si dhe strukturat e partneritetit të krijuara përmes proceseve gjithëpërfshirëse dhe me orientim nga poshtë-lart, pavarësisht nëse janë pasive apo aktive, janë të rëndësishme në krijimin e terrenit të përshtatshëm për zbatimin e qasjes Leader. Këto nisma dhe të tjera të natyrave studimore, të ndërtimit të kapaciteteve, rrjetëzimit dhe advokacisë etj, kanë hapur rrugë për të nisur një sipërmarrje kombëtare të zbatimit të qasjes Leader.

Masa kritike e burimeve njerëzore të trajnuara, që kanë njohuritë dhe aftësitë bazë për t'u angazhuar në nisma të tipit Leader, hapësirat rrjetëzuese dhe shkëmbimit të përvojave të krijuara në pesë vitet e fundit nga ANRD, lidhësi i fortë vendor për të nxitur proceset animuese në disa territore rurale, por mbi të gjitha spiralja rënëse e komuniteteve rurale dhe mbështetja që ofron IPARD III krijojnë një momentum të pazëvendësueshëm për t'i dhënë zbatimit të qasjes Leader një hov të ri dhe për të hapur një periudhë të re për këtë instrument evropian në rigjallërimin real të jetës dhe ekonomisë rurale. Ky aktivitet organizohet në kuadër të projektit *"Mbështetje për BRDN në zhvillimin institucional për të revitalizuar komunitetet rurale në Ballkanin Perëndimor"*, mbështetur financiarisht nga We Effect.

## Agjenda

- 10:30** Hapja e eventit dhe mirëseardhje nga ana e organizatorëve
- 10:35** **Prezantim:** Dy fjalë mbi dinamikat e zbatimit të qasjes Leader në Shqipëri: nisma, territore dhe struktura partneriteti, Evelina Azizaj, Koordinatorë Kombëtare
- 10:45** **Sesion pjesëmarrës:** Zëra nga terreni: Historia e nismave dhe partneriteteve të krijuara në frymën e qasjes Leader (2 runde me 15 minuta). *Pjesëmarrësit janë të lutur të zgjedhin dy nga praktikat konkrete të cilat dëshirojnë t'i njohin më mirë dhe të ndërrojnë praktikën sipas rundeve.*
- Në katër këndet e sallës janë vendosur dy raste të praktikave konkrete të zbatimit të qasjes Leader. Personat kyç të çdo rasti do të prezantojnë dhe përgjigjen pyetjeve të pjesëmarrësve jo më shumë se 7 min mbi GLV e territorit të tyre. Përveç prezantimeve, personat kyç mund të ndajnë me pjesëmarrësit materiale promovuese (fletëpalosje, strategji, album fotosh, video etj) për komunitetin, GLV-në, dhe nismave të ndërmarra etj.*
- 11:15** **Prezantim:** Cfarë ofron IPARD III për zbatimin e qasjes Leader? Po Asistenca teknike e IPARD II? Rolet e Institucioneve në këtë sipërmarrje? Grigor Gjeci, Kreu i Autoritetit Menaxhues, Programi IPARD, MBZHR
- 11:30** ***Sesion Pyetje dhe Përgjigje***
- 11:45** ***Sesion vlerësimi: Vlerësim i shpejtë i nevojave të aktorëve vendor mbi qasjen Leader***
- 12:00** **Njohuri, kapacitete dhe aftësi: situata aktuale dhe prioritetet**
- Qasja Leader, ndërtimi i partneriteteve, grupet lokale të veprimit
  - Planifikimi strategjik vendor me pjesëmarrje
  - Planifikimi dhe menaxhimi i projekteve/nisma vendore
- 12:45** ***Sesioni përmblyës: Përfundimi i eventit: Prezantimi i diskutimeve sipas tematikave***
- 13:00** Bufe